

**Për:** Klientët e Iutecredit Kosova J.S.C

**Nga:** IuteCredit Kosovo" J.S.C.me numër të regjistrimit të biznesit 71358747, numër fiskal 601744148, me seli në adresën Rr."Bill Klinton Mulliri i Praskut, objekti A2, L.L.B 1, Lokali 2, 10000, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga z.Shpend Maxhera, Drejtor Menaxhues

**Lënda:** Njoftim për Ndryshimin e kushteve të Kontratës së Huasë – Kushte të Përgjithshme për kreditë e lëshuara nga data 27.11.2017 deri me 01.06.2018

Prishtinë, me datë 01.06.2018

Të nderuar klientë,

IutCredit Kosovo J.S.C. (këtej e tutje: "ICKO") po ju drejtohet me këtë Njoftim për të ju informuar lidhur me ndryshimet që do të bëhen në Kontratën e Huasë – Kushte për kreditë e lëshuara nga data 27.11.2017 deri me 01.06.2018 mes jush dhe ICKO-së (këtej e tutje: "Kontrata e Huasë").

Ndryshimet janë si në vijim:

Shtohet:

"Neni 7 - Bonusi i referimit

7.1 Në rast se Huamarrësi referon ndonjë person tjetër që të merr hua pranë ICKO atëherë Huamarrësi përfiton zbritje në komisionet e huasë së tij aktive apo të ardhshme në pajtim me kushtet si në vijim:

7.1.1 Personi i referuar nuk ka qenë klient i mëparshëm i ICKO-së.

7.1.2 Personi i referuar e jep të saktë dhe të plotë numrin e referencës të huasë së Huamarrësit.

7.1.3 Huamarrësi nuk është në vonesë të kthimit të huasë për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

7.2 Zbritja e komisionit për një person të referuar është 5 EURO të huasë aktive duke filuar nga kësti i fundit. Në qoftë se Huamarrësi nuk ka hua aktive, atëherë zbritja do të ruhet për huanë e ardhshme.

7.3 Në qoftë se Huamarrësi referon disa persona e si rrjedhojë ka arritur zbritje deri në lartësi prej 50% të komisionit total, atëherë zbritjet e rradhës automatikisht do të ruhen për huanë e ardhshme.

7.4 Zbritja e komisionit do të ndalojë së zbatuari nëse personi i referuar bjen në vonesë për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë në shlyerjen e huasë së tij.

7.5 Në qoftë Huamarrësi është person i referuar atëherë përfiton zbritje në komision në lartësinë e përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni. Paragrafet e tjera të këtij neni zbatohen përshtatëshmërisht."

Plotësohet neni 11 i Kontratës së Huasë, ashtu që shtohet paragrafi 5 si në vijim:

“11.5. ICKO rezervon të drejtën që në çdo kohë të bëj ndryshime në kushtet e kësaj kontrate. Në rast të çdo ndryshimi, ju do të njoftoheni në kontaktet tuaja personale një (1) muaj përpara se ndryshimi të hyj në fuqi.”

Me ndryshimet e fundit, kjo dispozitë do të ketë numrin 12.5.

Ndryshohet:

Neni 8 – Rastet e mos permbushjes dhe të shlyerjes së huasë

8.3

Mesazhi i dytë përkujtues (SMS) – Dita e 14-të e vonesës

Mesazhi i tretë përkujtues (SMS) – Dita e 24-të e vonesës

Mesazhi i katërt përkujtues (SMS) – Dita e 34-të e vonesës

Thirrja e parë përkujtuese - Dita e 6-të e vonesës

Thirrja e dytë përkujtuese - Dita e 16-të e vonesës

Thirrja e tretë përkujtuese (inkasim i borxhit) – Dita e 36-të e vonesës

Letra e parë përkujtuese - Dita e 10-të e vonesës

Letra e dytë përkujtuese – Dita e 20-të e vonesës

Letra paralajmëruese për shkëputje të kontratës – Dita e 30-të e vonesës

Me ndryshimet e fundit, kjo dispozitë do të ketë numrin 9.3.

Ndryshimet do të jenë efektive në Kontratën e Huasë një muaji pasi ta keni pranuar këtë njoftim. Për të shmangur çdo dyshim, moment i pranimit konsiderohet momenti kur mesazhi elektronik ka arritur në mënyrë të sukseshme në e-mailin apo telefonin tuaj.

Dorëzuar me respekt,

  
Shpend Maxhëra – Drejtor Ekzekutiv

